



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 281/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër Hajriz Morinës anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë, për shkak të manipulimit me formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) në qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014 mori këtë:

## VENDIM

**I. Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

**II. Koalicionit për Kosovën e Re (KKR)** i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**III. Hajriz Morina** anëtarë pran KKZ-së në Malishevë nga Kosalicioni për Kosovën e Re (KKR), i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje për 5 vite nën autoritetin e KQZ-së si kandidat i ndonjë partie tjetër, apo si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor.

## Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga LVV dega në Malishevë në të cilën theksohet se me datën 09.06.2014 në orën 02:15 të mëngjesit në zyrat e KKZ-së në objektin komunal në Malishevë, Hajriz Morina anëtarë i Koalicionit për Kosovën e Re (KKR) pran Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë është zënë në flagrancë duke manipuluar me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK), ku ai përmes një lapsi me gomë të modifikuar ka bërë ndërhyrje, (fshirje-shënim) në FRK duke ndryshuar rezultatet e votave. Këto shkelje ka arritur që të zbuloj anëtarë i LVV-së në KKZ Valon Hoti ku përmes vëzhgimit ka arritur që të siguron prova materiale dhe incizime dhe fotografi, si dhe menjëherë në prezencën e të gjithë stafit të KKZ-së, anëtarëve të subjekteve politike në KKZ, trajnerëve dhe kryesuesve të QV në Drenovc, ka njoftuar policinë e Kosovës e cila e ka arrestuar të dyshuarin dhe gjatë kontrollit të tij ka gjetur mjetin e modifikuar (lapsin grafik me gomë) me të cilin është kryer manipulimi në FRK-të. Parashtruesi i ankesës thekson se veprimi i ndërmarë nga Hajriz Morina mund të ketë shkaktuar pasojën në masë shumë më të madhe se sa është evidentuar fillimisht me ndërhyrjen në FRK, pasi që i njëjti më parë ka bërë përpunimin e të dhënave për Formularët e Rezultateve të

Kandidatëve dhe Formularëve të Përputhjes së Rezultateve. Parashtruesi i ankesës dyshon se këto ndërhyrje në ndryshimin e të dhënave në FRP dhe FRK mund të jenë ndërmarë në dobi të subjektit politik Nisma për Kosovë, dhe si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur deklaratën e Valon Hotit dhe fotografit nga vendi i ngjarjes dhe mjetit me të cilin është ndërmarë veprimi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AKR lidhur me ankesën në fjalë dhe kërkoi përgjigjen me shkrim për sqarim të mëtutjeshëm.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AKR, në të cilën përgjigje theksohet se personi në fjalë Hajriz Morina nuk është anëtarë i KKR-së pasi që në këto zgjedhje nuk ka ndonjë subjekt politik që ka konkurruar si KKR, por se i njëjti person është anëtar i KKZ-së në Malishevë i subjektit politik Nisma për Kosovë, dhe se si përfaqësues i AKR-së në KKZ-në në Malishevë është Qazim Sopaj.

Lidhur me këtë çështje PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi të ndërmarr veprimet e nevojshme për këtë rast.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se për personin e dyshuar Hajrzi Morina është hapur rasti me nr. 2014-GE-328 ku me vendim të prokurorit të shtetit është hapur rasti si keqpërdorim i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve dhe se i dyshuari është ndaluar në mbajtje për 48 orë.

PZAP-i për personin në fjalë kërkoi informacione edhe nga KQZ-ja lidhur me verifikimin e anëtarit të KKZ-së për komunën e Malishevës se nga cili subjekt politik është nominuar.

Në përgjigjen e saj KQZ-ja thekson se nga emërimet finale në listën e anëtarëve në KKZ për komunën e Malishevës të emëruar nga KQZ-ja, Hajriz Morina figuron në numrin 239 i nominuar nga Koalicioni për Kosovën e Re (KKR) dhe se si dëshmi ka bashkangjitur listën me emrat për emërimet e bëra nëpër Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) për Zgjedhjet 2014

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë të bazuara pasi që Hajriz Morina në anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Malishevë nga Koalicioni për Kosovën e Re (KKR) i emëruar nga KQZ-ja si në KKZ Malishevë për zgjedhjet e 2014, ka kryer veprime të kundërligjshme sipas LQP-së ku është zënë duke manipuluar me Formularët e Rezultatete Kandidatëve (FRK) dhe nga Policia e Kosovës ju ka gjetur mjeti i modifikuar (lapsi grafik me gomë) me të cilin ka bërë ndërhyrjet (fshirje –shënim) në FRK. Kto veprime të kundërligjshme vërtetohen edhe përmes raportit policor 2014-GE-328 për të cilin i dyshuari është ndaluar në mbajtje dhe se ndaj tij është hapur rasti për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve.

PZAP-i duke vendosur për gjobën ka vendosur në pajtim me nenin 118 paragrafi 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika c) të LQP, ku është paraparë se PZAP-i ndaj një

subjekti politik mund të shqiptoj një gjobë deri në 50.000 €. PZAP-i është i bindur se me gjobën e shqiptuar do të arrihet qëllimi i gjobitjes për subjektin e lartë përmendur në veqanti, dhe për subjektet tjera që bëjnë shkelje të tilla të ligjit në përgjithësi. Ndërsa sa i përket ndalimit për pjesëmarrje në zgjedhje ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi, ka vendosur në pajtim me nenin 120.3 pika d) të LZP, me q' rast ka marrë në konsiderim se, shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e zgjedhore, rrethanë kjo që ka ndikuar në shqiptimin dhe kohëzgjatjen e masës së ndalimit për personin e lartpërmendur në tërësi si në pikën III të dispozitivit.

Prandaj nga arsyet e lartcekura, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, dhe në pajtim me dispozitat e lartë përmendura ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 281/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*